

Forumi për Siguri rekomandon - Gjithëpërfshirja dhe transparenca, të detyrueshme për Strategjinë e re të

Procesi i hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës – është konsideruar si proces jo transparent dhe aspak gjithëpërfshirës ndaj në analizën e bashkëngjitur do të gjeni rekomandimet e dakorduara gjatë takimit dhe diskutimeve të ekspertëve, anëtarë të Forumit për Siguri, të kryesuar prej FIQ. [Më shumë...](#)

Analizën e lartpërmendur së bashku me masat e nevojshme mund ta lexoni [KËTU](#).



NDRYSHIMI I PERCEPTIMEVE NËPËPËRMJET INOVACIONIT

Kosova ofron potenciale për zhvillimin e Ekonomisë së Gjelbërt dhe të qëndrueshme. Kjo gjetje mbështetet prej interesit të jashtëzakonshëm të treguar për pjesëmarrje në konkursin kombëtar për “Biznes plane – Ide të Gjelbërta dhe Inovative”.


Lexoni [më shumë](#) dhe vizitoni galerinë me [foto](#) me të reja nga eventi kombëtar dhe rajonal mbështetur prej RBF-it “Biznes Plane – Të gjelbërta dhe Inovative”



SIGURIA NE RAJON – Rëndësia e Bashkëpunimit rajonal në parandalimin e Konfliktëve; Forumi për Siguri – Kosovë

Bashkëpunimi rajonal për integrim Europian, konsiderohet si jetik për përparimin e rajonit. Një vlerësim i raporteve të Kosovës me vendet e rajonit ishte një ndër vlerat e shtuara prej FIQ, gjatë punimeve të Konferencës rajonale në fushën e sigurisë, të mbajtur në Kampin REACT (Kampi Rajonal Euro-Atlantik), në Plavë të Malit të Zi, Gusht 2013.

Njihuni me pikëpamjet dhe qëndrimin e FIQ në lidhje me sfidat, bashkëpunimin në nivel rajonal si dhe prezantimin e kontributit të shoqërisë civile kosovare në promovimin dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë. [Më shumë...](#)



KONKURS PËR ESE

FIQ – nxit të menduarit dhe të shkruarit e lirë për qytetarinë aktive.

Forumi për Iniciativa Qytetare FIQ, fton të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të marrin pjesë në konkursin për esen më të mirë në tema e mëposhtme:

- **Qytetaria aktive** - Nevojat dhe Rëndësia e të qenit Qytetar Aktiv në një shoqëri
- **Vlerat e shoqërisë kosovare ndër shekuj** – Filantropia dhe bamirësia
- **Personazhi inspirues** – Po të ishit ai/ajo, çfarë do të bënit?

Konkursi mbetet i hapur deri më datë 15 Shtator 2013. [Më shumë...](#)

FIQ dhe OEAK dakordohen në domosdoshmërinë për të rishikuar projektligjin e zvarritur për Sponzorizime dhe Donacione

Forumi për Iniciativa Qytetare në bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe në prani të përfaqësuesve të institucioneve publike, bizneseve dhe të organizatave të tjera joqeveritare argumentuan dhe u dakorduan mbi një sërë masash të nevojshme me qëllim hartimin e një ligji gjithëpërfshirës, koherent dhe me një gamë të gjërë fushë veprimi. [Më shumë...](#)



AKTIVIZMI QYTETAR – FUQIZIMI I KOMUNITETEVE

Historitë e suksesit dhe nevojat për rritje të pjesëmarrjes së qytetarëve

Forumi për Iniciativa Qytetare – FIQ, në një tryezë diskutimi publikoi analizën “Aktivizmi Qytetar në Kosovë”, ku u diskutua rreth konceptit të aktivizmit qytetar, përvojave dhe praktikave të mira nëpër gjithë vendin dhe mundësitë se si këto praktika do të mund të merreshin nga komunitete më pak ose fare aktive në vend.

Analizën e lartpërmendur, me shembuj dhe praktika të realizuara, mund ta gjeni [KËTU](#).



**Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives**

Rr. Rexhep Mala 5/A 10 000 Prishtine, Kosove

+381 (0) 38 248 677 +386 (0) 43 733 454 | info@fiq-fci.org | www.fiq-fci.org



“Të mësojmë prej komunitetit” - Roli i qytetarëve në politikat komunale, mundësitë dhe realiteti ekzistues në Komunën e Klinës

Nisur nga shqetësimet e identifikuara gjatë zbatimit të projektit “Qytetari Aktive për Politikat Publike Komunale” mbështetur prej FIQ, OJQ “KOHA” e thirri këtë tryezë për të nxjerrë në pah qëndrimet dhe argumentet e të gjithë palëve të interesuar për gjetjen e një mekanizmi bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës. [Më shumë...](#)



Reagimet në situata emergjente – Analiza dhe masat e nevojshme

Tryeza e organizuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare në kuadër të Forumit për Siguri synon të kontribuojë në rritjen dhe përmisimin e situatës aktuale të kapaciteteve të komunave për ndërhyrje në raste emergjente. [Më shumë...](#)

Analizën e lartpërmendur mund ta gjeni [KËTU](#).



Mbledhje fondesh për Zhvillim të Qëndrueshëm - Thirrje për Pjesëmarrje në Akademinë për Qëndrueshmëri

FIQ si pjesë e projektit rajonal "SIGN për Qëndrueshmëri", të zbatuar nga SIGN Network, rrjet i donatorëve indigjen nga Ballkani Perëndimor që financohet nga Bashkimi Evropian përmes (IPA) Civil Society Facility (CSF), ka shpallur thirrjen për pjesëmarrje në Akademinë për Qëndrueshmëri, e cila ofron njohuri të mjaftueshme për OJQ-të, respektivisht për mbledhjen e fondeve, kryesisht në komunitetin ku veprojnë, duke planifikuar strategjikisht këtë segment, pra ngritjen e fondeve. [Më shumë...](#)

Bashkëpunimi rajonal - Transformimet ushtarake në rajon

Në konferencën rajonale “Transformimet ushtarake në rajon”, Forumi për Siguri ka publikuar edhe një dokument diskutimi që reflekton të arriturat e FSK dhe rrugën e saj të transformimit në ushtri.

Në këtë konferencë të ndarë në tri sesione: Transformimet ushtarake dhe politikat e mbrojtjes; Procesi i integritimit në NATO; Bashkëpunimi ushtarak rajonal në mes vendeve tona, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia kanë sjellë vështrime të reformave dhe transformimeve të ushtrive të këtyre vendeve. [Më shumë...](#)



Deklaratë nga Forumi për Iniciativa Qytetare kundër Projektligjit për Amnisti

Prishtinë 04.07.2013, Forumi për Iniciativa Qytetare përmes kësaj deklatare shpreh indinjatë të thellë ndaj miratimit të Projektligjit për Amnisti i hartuar në bazë të bisedimeve ndërmjet kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe atij të Republikës së Serbisë.

Forumi për Iniciativa Qytetare gjykon se, mungesa e debateve publike para miratimit të një dokumenti politik të një rëndësie të veçantë, përbën shkelje të të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, shtrembërim të normave demokratike për të cilat qeveria aktuale shprehet se është tejet e angazhuar. Çdo përpjekje qeveritare për të mbajtur larg procese vendimmarrëse, shoqërinë civile, qytetarët dhe zërat apolitik të vendit, kompromenton procesin e hartimit të këtij projektligji, përmbajtja e të cilit cënon bazat e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, Forumi për Iniciativa Qytetare gjykon, se projektligji për amnisti nuk ndihmon aspak në konsolidimin e shtetit ligjor dhe demokratik, por përkundrazi vendos shenjë të barazimit ndërmjet kriminelëve dhe qytetarëve të tjerë të respektueshëm të vendit tonë si dhe cënon sigurinë e përditshme të qytetarëve të Kosovës.



FIQ, GAP dhe INDEP publikojnë analizën “Hesapi i rrymës”

Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID) sot mbajti konferencë për media, ku u publikua analiza e shkurtër e situatës momentale në sektorin e energjisë e titulluar “Hesapi i rrymës”. Kjo analizë është e para në radhën e një serie botimesh që KOSID është duke i përgatitur, e që kanë për qëllim propozimin e politikave konkrete për zgjidhjen e çështjes së përballeshmërisë së faturave të rrymës, nga ekonomitë familjare në Kosovë. [Më shumë...](#)

Analizën e lartpërmendur mund ta gjeni [KËTU](#).

FIQ organizon takime me qytetarë për të parë dhe adresuar nevojat e tyre në institucionet gjegjëse

FIQ, në projektin e përbashkët me Saferworld dhe AKTIV, në bashkëpunim me një sërë organizatash tjera lokale, nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, kanë mbajtur takime me qytetarë, me qëllim diskutimi dhe analizimi të çështjeve të ndryshme ditore që kanë ndikim thelbësor në paqen dhe sigurinë në komunitete. Informacionet nga këto takime, do të shfrytëzohen për nevoja të hulumtimeve, të parapara me këtë projekt, ndërkohë që një analizë e politikave do të publikohet mëpastaj në mënyrë që të avokohet tek institucionet vendim-marrëse për çështjet dhe brengat e adresuara nga qytetarët.

Ekonomia e gjelbërt – A na përfshinë ne?

Në prag të Ditës Botërore të Mjedisit, Qendra Informative dhe Kulturorë e BE-së, organizoi debatin me titull “Ekonomia e gjelbër - A do të na përfshijë?”, ku si paneliste ishte e ftuar znj. Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive e FIQ-it. FIQ në këtë debat argumenton rëndësinë që ekonomia e gjelbërt duhet të ketë për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës.

Menaxhimi i mbeturinave, riorientimi i politikave publike drejt energjisë së ripërtëritshme, efikasiteti i energjisë dhe izolimi i ndërtesave, jeta pas Kosovës A ishin temat e debatit të organizuar nga EUICC. [Më shumë...](#)





KONKURS

Çmimi FIDES për Filantropi në Kosovë 2013

Për të pestin vit me rradhë, Forumi për Iniciativa Qytetare shpallë konkursin për dhënien e Çmimit FIDES për filantropi në Kosovë.

Çmimi FIDES simbolizon mirënjohje për kompanitë dhe individët nga Kosova dhe Diaspora, të cilët në mënyrë sistematike dhe të kujdesshme kanë përkrahur aktivitetet dhe projektet e interesit të përbashkët apo individët.

Kategoritë e çmimit FIDES 2013 janë:

- Çmimi FIDES për kontribut në nivel kombëtar
- Çmimi FIDES për kontribut lokal në komunitetin, ku vepron kompania
- Çmimi FIDES për kontribut individual
- Çmimi FIDES “Diaspora” për individët dhe bizneset e diasporës
- Çmimi FIDES për “filantropët e rinj”

Kërkesat për konkurrim:

- Për këtë konkurs, aktivitetet e nominuara të kompanisë/ndërmarrjes apo individit duhet të jenë të implementuara gjatë vitit 2013.
- Në konsideratë do të merren vetëm aplikacionet e plotësuara në mënyrë të rregullt, siç është përkshkruar në formularin zyrtar të FIQ për aplikim (që mund të gjendet në faqen tonë të internetit: www.fiq-fci.org), dhe të cilat dërgohen para skadimit të afatit.

Si të aplikohet:

- Online përmes faqes zyrtare të FIQ - www.fiq-fci.org
- Të shkarkojnë aplikacionin nga faqja zyrtare e FIQ www.fiq-fci.org ose
- Të pranojnë një formë të tillë përmes email-it

Forma e aplikimit duhet të plotësohet në tërësi dhe i gjithë materiali relevant (fotografitë, raportet, video materialet, materialet e printuara, etj.) duhet të jenë të bashkangjitura me formën e aplikimit.

Konkursi për aplikim është i hapur deri më **31 Tetor 2013**. Kompanitë dhe individët që marrin pjesë në konkurs, mund të konkurrojnë **vetë ose të nominohen** nga të tjerët.

Për më shumë informata telefononi në +381 38 24 86 77 ose +386 43 733 454, apo na shkruani në adresën tonë elektronike fides@fiq-fci.org.

Shënim: Për më shumë informacione rreth aktiviteteve tona, mund të na ndiqni përmes web faqes www.fiq-fci.org, ose përmes llogarisë tonë të facebook-ut në këtë [LINK](#).

**Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives**

Rr. Rexhep Mala 5/A 10 000 Prishtine, Kosove
+381 (0) 38 248 677 +386 (0) 43 733 454 | info@fiq-fci.org | www.fiq-fci.org